

# RELACION

## PËR

### AKTIN NORMATIV “PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR.88/2019, “PËR BUXHETIN E VITIT 2020, TË NDRYSHUAR”

#### A. MËNYRA E NDËRHJRJES

Ky akt normativ propozohet në mbështetje të nenit 101 të Kushtetutës. Në këtë dispozitë kushtetuese parashikohet që Këshilli i Ministrave ka të drejtën e nxjerrjes së këtyre akteve normative me fuqinë e ligjit.

Akti normativ, gjithashtu, plotëson të gjitha kriteret e analizuara nga Gjykata Kushtetuese në vendimet e saj, veçanërisht vendimi nr.24, datë 10.11.2006, vendimi nr.23, datë 16.4.2014, etj. Konkretisht, për miratimin e një akti normativ kërkohet të plotësohen kushtet që vijojnë<sup>1</sup>:

- 1. Nevoja dhe urgjenca si kushte për nxjerrjen e aktit normativ me fuqinë e ligjit;*
- 2. Përkohshmëria e masave që përmban akti normativ me fuqinë e ligjit;*
- 3. Fuqia ligjore e këtyre akteve dhe kufizimet për nxjerrjen e tyre;*
- 4. Miratimi i aktit normativ me fuqinë e ligjit nga Kuvendi.*

#### **1. Nevoja dhe urgjenca si kushte për nxjerrjen e aktit normativ me fuqinë e ligjit;**

Neni 101 ka parashikuar ‘**nevojën**’ dhe ‘**urgjencën**’ si rrethana dhe situata fakti që vlerësohen rast pas rasti. Ministria e Financave dhe Ekonomisë ka ndërmarrë procesin dhe ka përgatitur skenarin e rishikimit të buxhetit 2020. Ky rishikim propozohet t’i nënshtrohet procedurës së aktit normativ, aspekti i nevojës dhe emergjencës të së cilit lidhet me financimin e paketës së dytë të masave anti-COVID19 të qeverisë dhe, konkretisht,:

- ✓ *Përmes një alokimi shpenzimesh në masën 7 miliardë lekë për këtë qëllim;*
- ✓ *Përmes miratimit të një garancie sovrane në masën 15 miliardë lekë.*

---

<sup>1</sup> Vendimi i Gjykatës Kushtetuese Nr.24, datë 10.11.2006

Njëkohësisht, **nevoja dhe urgjenca** konsiston edhe në faktin se si rezultat i gjendjes aktuale të emergjencës shëndetësore, ky akt normativ synon:

- a) të reflektojë reduktimin në masën 7 miliardë lekë të zërave të shpenzimeve buxhetore, korente dhe kapitale, referuar kursimeve të evidentuara dhe atyre të pritshme për vitin 2020;
- b) të reflektojë rritjen në masën 7 miliardë lekë të paketës financiare në mbështetje të masave anti-Covid19.
- c) Ruajtjen të pandryshuar të deficitit buxhetor, për rrjedhojë.

## **2. Përkohshmëria**

Akti normativ vepron me fuqinë e ligjit për një periudhë kohe, maksimalisht 45-ditore. Përkohshmëria e këtij akti lidhet me kushtin e domosdoshëm të shqyrtimit të tij nga Kuvendi, i cili, nëse e miraton, e kthen atë në ligj. Për këtë arsye, menjëherë pas miratimit të aktit normativ me fuqinë e ligjit nga Këshilli i Ministrave, ky akt do të dërgohet për miratim në Kuvend, me qëllim fillimin e procedurave parlamentare përkatëse.

## **B. QËLLIMI I HARTIMIT TË KËTIJ AKTI NORMATIV**

Në terma konkretë dhe të detajuar, akti normativ përcakton dhe synon:

- të akordojë një fond prej 7 miliardë lekësh në zërin “Kontingjenca për paketën sociale anti-COVID”, e cila do të përdoret me vendim të Këshillit të Ministrave. Ky fond i dedikohet financimit të masave të reja me karakter social që do të ndërmarrë qeveria, në funksion të lehtësimit e të mbështetjes së punëmarrësve dhe/ose shtresave të tjera të prekura nga pezullimi i proceseve të punës në shkallë vendi, si për biznesin e madh ashtu edhe për pjesën e mbetur të biznesit të vogël.
- të reflektojë një total pakësimesh prej 7 miliardë lekësh, me qëllim financimin e paketës së re anti-COVID19, pra pa kosto shtesë në buxhet, konkretisht përmes:.
  - kursimeve në shpenzimet e personelit rreth 829 milionë lekë;

- kursimeve në shpenzime operative rreth 1.28 miliardë lekë, ku ndër kryesoret përmendim:
  - Rreth 582 mln lekë kursime të evidentuara nga ngadalësimi i aktivitetit të institucioneve buxhetore për periudhën mars-maj.
  - 700 mln lekë nga kontrata vjetore e Rapiscan.
  
- kursimeve në investimet me financim të brendshëm rreth 4.25 miliardë lekë, konkretisht:
  - Rreth 1 miliard lekë nga projektet e shkollave;
  - Rreth 1 miliard lekë nga projekti i Rrugës së Arbrit;
  - Rreth 1 miliard lekë nga Ministria e Mbrojtjes;
  - Rreth 800 milionë lekë nga kontratat e inceneratorëve Fier & Elbasan.
  
- kursimeve në investimet me financim të huaj rreth 634 milionë lekë.

Ndërkohë, në paketën e masave për përballimin e situatës emergjente anti-COVID-19 është përfshirë edhe mbështetja për biznesin, në formën e instrumentit të garancisë së re sovrane, në masën 15 miliardë lekë. Ajo do të shkojë si garanci për kompanitë që janë gjendur përballë vështirësive, jo vetëm për pagesën e pagave të punonjësve gjatë këtyre muajve, por edhe në nivel kapitali apo likuiditeti në tërësi.

Në përfundim, është me rëndësi të theksohet që ndryshimet e propozuara nuk prekin deficitin buxhetor, duke treguar një kujdes maksimal për t'i destinuar dhe orientuar burimet buxhetore drejt sektorëve më emergjentë. Në vijim, qeveria do të ndjekë me kujdes maksimal ecuringun e treguesve kryesorë makroekonomikë, me objektiv primar përmirësimin e tyre gradual dhe ruajtjen e qëndrueshmërisë fiskale.

## **KËSHILLI I MINISTRAVE**